



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami , anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Terminal” Sh.p.k me seli në Han të Elezit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sabri Kryeziu, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Hanit të Elezit, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.396/22 të datës 19.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Terminal” Sh.p.k me seli në Han të Elezit, e datës 23.01.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.396/22 të datës 19.12.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.396/22 të datës 19.12.2023, në pikën I. është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Terminal” Sh.p.k me seli në Han të Elezit, në pikën II. mbetet në fuqi vendimi nr.08-nr.3130/21 i datës 26.04.2021 i Komunës së Hanit të Elezit. Ndërsa në pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar për shkak të: shkeljes së dispozitave procedurale dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim ose aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të ndryshohet, padia e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar dhe të anulohen vendimet e të paditurës 08 nr. 2648/77 i datës 30.03.2021 dhe 08- nr. 3130/21 i datës 24.05.2021 duke e liruar paditësin nga pagesa e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit për vitin 2021 dhe borxhi paraprak në shumë prej 102,750.00€.

E paditura me datë 29.01.2024 ka paraqitur përgjigje në ankesë, në të cilën ka theksuar se e kundërshton në tërësi ankesën e paditësit dhe ka konsideruar se vendimi i Gjykatës Komerciale KF.nr.396/22 është vendim i bazuar mirë në dispozita ligjore dhe me të drejtë padia e paditësit është refuzuar, andaj ka propozuar që edhe Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë ta refuzoj ankesën e palës paditëse si të pa bazuar.

Kolegji Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, pas vlerësimit të aktgjykimit të ankimuar, pretendimeve ankimore, në pajtim me nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin nr.08 nr.3130/2021 të datës 24.05.2021, të paditurës Komuna e Hanit të Elezit, është refuzuar ankesa e Terminali Sh.p.k e parashtruar pranë Komunës së Hanit të Elezit përkatësisht komisionit për procedurën e zgjedhjes së kontesteve dhe ankesave, kundër aktvendimit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik për caktimin e taksës vjetore komunale me numër 08 nr.2648/77-2021 të datës 30.03.2021 dhe mbetet në fuqi vendimin i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik për caktimin e taksës vjetore komunale për ushtrimin e aktivitetit afarist në territorin e Komunës Hani Elezit me numër 08 nr.2648/77-2021 të datës 30.03.2021.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Hanit të Elezit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 01.06.2021, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit nr.08 nr.3130/2021 të datës 24.05.2021, të paditurës Komuna e Hanit të Elezit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e lartcekur. Me arsyetim se nga provat shkresore të administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata ka pranuar si të ligjshëm dhe të drejtë arsyetimin e vendimit të paditurës për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentoj me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjukata konstaton se në nenin 11 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, si ligj i aplikueshëm në këtë rast është parashikuar se Kuvendi i Komunës dhe kryetari kanë të drejtë të miratojnë akte dhe të ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre. Të gjitha aktet komunale duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës”. Ndërsa në nenin 8 pika a) të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal është parashikuar se “të gjitha të hyrat e mbledhura ose të pranuar nga Komuna në bazë të autorizimit të një ligji nga burimet në vijim, janë të hyra vetanake të Komunës: a) taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga komuna si dhe detyrimet rregullatorë dhe gjobat e autorizuara në bazë të këtij ligji” në nenin 14.1 të këtij ligji është përcaktuar se “Përmes një rregulloreje, komuna mundet (i) të kërkoj nga një person i cili dëshiron të bëjë ndërrimin ose rrënimin e një ndërtese ose strukture tjetër brenda komunës që të marrë leje për këtë qëllim dhe (ii) të përcaktojë një skemë tarifore për këto leje e cila vendos taksa të ndryshme në bazë të sipërfaqes në të cilën ndodhet ose në të cilën do të ndërtohet ndërtesa ose struktura” duke pas parasysh këto dispozita e paditura ka nxjerr rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha 01.nr.6866/2018 e cila ka paraparë taksa vjetore komunale. Gjukata vlerëson se rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Gjoha 01. Nr.6866/2018 e Komunës së Hanit të Elezit është nxjerr në pajtim me ligjin dhe se organi mbikëqyrës Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e linjës Ministria e Financave kanë bërë certifikimin e saj, gjë e cila theksohet edhe në vendimin e kontestuar të paditurës, gjykata thekson se caktimi i

taksave dhe i tarifave komunale paraqet veprimtari administrative e cila ushtrohet brenda kufijve të kompetencave. Si përfundim gjykata vlerëson se vendimi 08 nr.3130/21 i datës 26.04.2021 i Komunës së Hanit të Elezit, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit e ushtruar kundër vendimit të Komunës së Hanit të Elezit-Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik 08 nr.2648/77-2021 i datës 30.03.2021, sipas të cilit vendim paditësit i janë caktuar taksat komunale në shumë të përgjithshme prej 5,000.00€ në emër të taksës vjetore për vitin 2021, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar mbështetur nga dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e paditësit në ankesë se gjykata ka bërë shkelje procedurale nga neni 63 i LKA-së lidhur me nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së ngase aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen e sidomos dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyet e aktgjykimit, aktgjykimi nuk ka fare arsye dhe faktet vendimtare, pasi që ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet dhe përmbajtjes së dokumenteve dhe bazës ligjore. Dhoma e Shkallës së Dytë të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata me asnjë fjalë të vetëm në aktgjykimin e ankimuar nuk e ka arsyetuar pretendimine palës paditëse se vendimi i të paditurës për caktimin

e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit është i kundërligjshëm nuk bazohet në Ligjin për Financa të Pushtetit Lokal, nenin 10 të tij. Komuna nuk ka të drejtë të caktoj asnjë tarifë apo taksë tjetër e cila nuk është e përcaktuar me Ligjin e Pushtetit Lokal. Taksat Komunale për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste siç e ka caktuar e paditura me rregulloren e saj të brendshme i referohet marrjes së lejes për ushtrimin e veprimtarisë në lokalet brenda Komunës-ndërtesës së Komunës, çka në rastin konkret është e jashtëligjshme sepse paditësi nuk e ushtron veprimtarinë në lokalet e Komunës, dhe kështu Dhoma e Shkallës së Parë nuk e ka arsyetuar faktin se paditësi a është duke ushtruar veprimtarinë në lokalet brenda Komunës, dhe fare nuk e ka arsyetuar dhe interpretuar nenin 10 të Ligjit 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerëson se janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara. Kjo për faktin se pas shqyrtimit dhe analizimit të dispozitës ligjore dhe rregulloreve komunale, kolegji vlerëson se vendimi është konform ligjeve dhe rregulloreve të miratuara nga Komuna e Hanit të Elezit me anë të cilave përcaktohen taksat vjetore për kategoritë e ndryshme të veprimtarive afariste të cilat e ushtrojnë veprimtarinë afariste në territorin e Komunës dhe duhet të paguajnë taksën komunale për shërbime publike. Andaj, gjykata e shkallës së parë duke analizuar bazën ligjore të nenit të lartcekur, me të drejtë ka konstatuar se vendimi i të paditurës është i qartë dhe përmban elementet e detyrueshme të aktit të shkruar në pjesën hyrëse dhe urdhëruese, sikurse akti administrativ i të paditurës nr.08 nr.3130/2021 të datës 24.05.2021 me të cilin është konstatuar gjendja faktike lidhur me caktimit të taksave ndaj paditësit, ashtu edhe vendimi i kontestuar me padi përmbajnë pjesën hyrëse dhe pjesën urdhëruese në vështrim të nenit 47 par.1 pika 1.1, 1.2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu kolegji i kësaj gjykate vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore lidhur me at se Gjykata e shkallës së parë në dispozitivin e II të aktgjykimit të ankimuar i referohet një subjekti tjetër- Administratës Tatimore të Kosovës, e cila nuk ka qenë palë në procedurë, por një pretendim të tillë ky kolegji e refuzoj si të pa bazuar për faktin se ka vlerësuar se ka ndodhë vetëm një gabim teknik nga ana Gjykatës së Shkallës së Parë ngase në dispozitivin e II të aktgjykimit të ankimuar është shënuar numëri i vendimit në përputhje me vendimin e kontestues.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës

së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE EKOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.383/24, me datë 19.04.2024.

Kryetar i kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri